



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 396/6 prot.

Tiranë, më 23.9.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Natasha Prifti (Shallapi)
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.9.2021, është njoftuar vendimi nr. 392, datë 28.5.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Natasha Prifti (Shallapi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnjë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.9.2021, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 8.9.2021, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnjë dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

**2.** Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit znj. Natasha Prifti (Shallapi) ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezulton se:

**2.1 ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Natasha Prifti (Shallapi)*”<sup>2</sup>, ka referuar se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**2.2 DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës<sup>3</sup>, ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha \*\*\* Prifti (Shallapi)*”. Në vijim, me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja, me anë të shkresës me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2021<sup>4</sup>, ka përditësuar raportin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit dhe, pasi referon se informacionet e ardhura nga ana e autoriteteve verifikuese janë thjesht në kuadrin e sinjalizimeve, për rastin në fjalë, konkluzioni t’i mbetet Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen në saje të hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

**2.3 KLP**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>5</sup> për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi).

**3.** Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

---

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI-së, me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.11.2019.

<sup>3</sup> Shkresa e DSIK-së, nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017.

<sup>4</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së, nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2021.

<sup>5</sup> Raport i KLP-së, nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2019.

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe të mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: [...] *duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në shumën 1.648.646 lekë, për krijimin jo vetëm të pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2013 (përpara martesës ligjore), por edhe të blerjes së pasurive të tjera dhe kryerjes së shpenzimeve përpara vitit 2013, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 13-vjeçare (2001 – 2013), faktet dhe provat rrethanore të krijojnë bindjen se kjo mungesë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra [...]*<sup>6</sup>. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Bazuar në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit nga institucionet përgjegjëse dhe pas hetimit administrativ të kryer prej tij, ka arritur në përfundimin se: [...] *Subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi) ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 [...]*<sup>7</sup>. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Bazuar në nenin E të aneksit të Kushtetutës, nenin 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, denoncimet nga publiku, provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme [...]*<sup>8</sup>. Në këto kushte, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 392, datë 28.5.2021, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, ka vendosur: *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnjë.*

<sup>6</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 39, të vendimit.

<sup>7</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 42, të vendimit.

<sup>8</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 52, të vendimit.

## II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”<sup>9</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 65, pika 2<sup>10</sup> e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 8.9.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Natasha Prifti (Shallapi) (bashkëlidhur këtij ankimi).

5.1 Në mënyrë të përmbledhur, ONM vlerëson se vendimi i Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka mangësi serioze logjike në pjesën arsyetuese, rezultat i një procesi rivlerësimi të papërshtatshëm dhe jo të saktë. Komisioni, i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, çmon se një vlerësim i drejtë i kriterit të pasurisë në tërësinë e tij do të çonte në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, pasi ai ka dështuar për të arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, referuar nenit 59, paragrafi 1, pika “a”, lidhur me nenin 61, paragrafi 3, të ligjit nr. 84/2016.

5.2 Objekti i Rekomandimit lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, më konkretisht për çështjet si vijon: (A) Kursimet e deklaruar në *cash*, në vlerën 4.000.000 lekë, të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të cilat, ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, gjatë periudhës 2013-2016, kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë: (i) depozitën bankare, në vlerën 1.500 euro në \*\*\* Bank; (ii) blerjen e automjetit me targë \*\*\*, në vlerën 8.400 euro; (iii) depozitën bankare, në vlerën 1.300.000 lekë, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; (iv) kursimet në bankë të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 1.700.000 lekë dhe (v) çështje të tjera lidhur me kursimet *cash*, në shumën 4.000.000 lekë. (B) Pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar, në vlerën 1.600.000 lekë.

## III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

<sup>9</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

<sup>10</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi vendimin nr. 392/2021 dhe aktet shoqëruese të tij, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, çmon se vendimi është i cenushtëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohen edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar në këtë proces.

11. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe në nenet 4, 59/1 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik, ndaj vendimit nr. 392/2021 të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

#### **IV. Analiza e shkaqeve të ankimit**

##### **IV.A Kontrolli i pasurisë**

12. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

13. Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit rezulton se, gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar problematika mbi saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive, të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.

14. Subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është bërë subjekt deklarues prej vitit 2007, duke plotësuar dhe dorëzuar pranë ILDKPKI-së, deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie. Gjatë periudhës së deklaramit 2007-2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar dhe disponuar pasuri të luajtshme (automjete), dhe në formën e likuiditeteve, *cash* dhe llogari bankare.

15. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës, të deklaratave periodike vjetore dhe Deklaratës “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në analizën e shkakut të ankimit lidhur me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në krijimin e pasurive të deklaruara, në vëmendje të veçantë, likuiditetet *cash*, që kanë

shërbyer si burim krijimi për pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të.

**16. Likuiditetet në cash.** Për vlerësimin e saktësisë dhe mjaftueshmërinë e burimit të ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash*, Komisioneri Publik mban në vëmendje praktikën e konsoliduar të Kolegjit<sup>11</sup>, i cili ka vlerësuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike të interesave është mbizotërues, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila ka parashikuar në mënyrë të posaçme vlerën provuese të deklaratave periodike të interesave. Nisur nga kjo praktikë gjyqësore, në vlerësim të përmbajtjes së deklaratave periodike dhe asaj “Vetting”, për pasurinë në formën e likuiditeteve *cash*, konstatohet si më poshtë:

**17. Në lidhje me saktësinë e deklaramit**

17.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, nuk kanë deklaruar posedimin e kursimeve *cash*.

17.2 Në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Lekë gjendje në shtëpi, shuma 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

17.3 Në DV-2013, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Gjendje të ardhurash cash, krijuar nga puna në vite, prej vitit 1998. Vlera: 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

17.4 Në DV-2015, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: *Pakësim i gjendjes së të ardhurave cash (blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare). Vlera: 1.900.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

17.5 Në DV-2016, personi i lidhur ka deklaruar: *Pakësim i kursimeve. Vlera: 1.300.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.*

17.6 Në dosje të Komisionit, ndër të tjera, janë administruar dhe dy procesverbale të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), të mbajtura përkatësisht në datat 29.1.2016 dhe 23.2.2016.

17.6.1 Në procesverbalin e datës 29.1.2016, në përgjigje të pyetjes mbi gjendjen *cash*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>12</sup>: *“Gjendja cash, në shumën 4.000.000 lekë, vazhdon të jetë në banesë. Do e depozitohet në bankë e do ju paraqes vërtetim bankar. Kjo shumë është akumuluar me të ardhurat e b/shortit, veprimtaria private, shitje me pakicë (dyqan) me prindërit dhe më pas në emër të tij, si dhe punë të ndryshme private”.*

17.6.2 Ndërsa në procesverbalin e datës 23.2.2016, për të njëjtin fakt, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>13</sup>: *“Sqarohet se gjendja cash e deklaruar prej meje është pakësuar ndër vite. Deri në datën 31.12.2014, gjendja ka qenë 3.200.000 lekë. Gjatë vitit 2015 është pakësuar sërish gjendja cash, pakësim të cilin do e deklaroj në deklaramin e ardhshëm. Aktualisht, gjendja cash është depozituar në bankë në shumën 1.300.000 lekë”.* Në këtë procesverbal, subjekti ka deklaruar se në vitin 2013 ka harruar të deklarojë shpenzimet në shumën 600.000 lekë nga

<sup>11</sup> Vendimet (JR) nr. 11/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 dhe nr. 27/2020 etj.

<sup>12</sup> Referohuni përgjigjes së pyetjes nr. 6, në procesverbalin e datës 29.1.2016.

<sup>13</sup> Referohuni përgjigjes së pyetjes nr. 6, në procesverbalin e datës 23.2.2016.

kursimet e tij. Po ashtu, edhe për vitin 2014, ka harruar të deklarojë shpenzimet në shumën 800.000 lekë, pakësim nga gjendja *cash* e bashkëshortit<sup>14</sup>.

17.7 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave si më sipër, Komisioni, me anë të rezultateve të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duke vlerësuar se [...] *Ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, lidhur me deklaratimet e gjendjeve cash, pasi në procesverbalin e mbajtur në datën 29.1.2016, subjekti fillimisht deklaroi se gjendja cash prej 4.000.000 lekë (akumuluar me të ardhurat e bashkëshortit) është ende në banesë, ndërkohë që në procesverbalin e mbajtur në datën 23.2.2016, subjekti deklaroi se shuma prej 4.000.000 lekë është pakësuar ndër vite, deri në datën 31.12.2014 gjendja cash ka qenë 3.200.000 lekë. Gjatë vitit 2015 është pakësuar sërish dhe, aktualisht, gjendja cash është në shumën 1.300.000 lekë [...].*

17.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *në momentin që ne kemi përpiluar deklaratën "Vetting" nuk kemi pasur gjendje cash. Deklarimi i saktë pranë ILDKPKI-së është ai i bërë më datë 23.2.2016, pasi jam konsultuar edhe me bashkëshortin. Gjendja e cash-it ka qenë pasuri personale e bashkëshortit, e cila është administruar prej tij, prandaj nuk kam qenë shumë e saktë në deklaratimin e datës 29.1.2016. Pasi u konsultova me të, ai më shpjegoi se në fund të vitit 2014 nuk kishte deklaruar pakësimin e shumës 800.000 lekë, si dhe gjatë vitit 2015 ishte pakësuar sërish dhe më datë 23.2.2016 gjendja cash ka qenë 1.300.000 lekë. Mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes cash, e deklaruar pranë ILDKPKI-së në datë 23.2.2016, ka qenë një pakujdesi e bashkëshortit, por pa pasur si qëllim fshehjen e pasurisë apo burimit të saj. Në këto kushte, kjo pasaktësi nuk mund të shërbejë për marrjen e masës disiplinore.*

17.9 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare, për sa kohë që ky pakësim nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, por çmon të theksojë se subjekti e ka deklaruar vullnetarisht këtë pasaktësi në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 23.2.2016 ... dhe se kjo ndreqje bën që gjendja e likuiditeteve cash në deklaratën "Vetting" të jetë zero, çka përputhet me deklaratimin e subjektit në këtë deklaratë [...]*<sup>15</sup>.

**18.** Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 8.9.2021, ndan qëndrim të ndryshëm nga përfundimi i arritur nga Komisioni, lidhur me saktësinë e deklaratimit për likuiditetet *cash*, duke konstatuar situatën faktike si vijon:

18.1 Bazuar në deklaratat periodike vjetore rezulton se: (i) Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 600.000 lekë, ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklaratimin e tij të parë, në DV-2013, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 4.000.000 lekë. (ii) Si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi i lidhur me të, nuk rezulton të kenë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008-2014. (iii) Në DV- 2015 dhe 2016 deklarohet pakësimi i likuiditeteve *cash*, në total në shumën 3.200.000 lekë<sup>16</sup>. (iv) Bazuar

<sup>14</sup> Referohuni përgjigjes së pyetjes nr. 12, në procesverbalin e datës 23.2.2016.

<sup>15</sup> Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 35, e vendimit.

<sup>16</sup> Në DV-2015 pakësuar me 1.900.000 lekë dhe në DV-2016 pakësuar me 1.300.000 lekë.

në këto deklaramë, gjendja e likuiditeteve *cash*, në datën 31.12.2016, llogaritet në vlerën 1.400.000 lekë.

18.2 Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 29.1.2016, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* prej 4.000.000 lekë është ende në banesë, ndërsa në DV-2015, dorëzuar në ILDKPKI në datë 21.3.2016, pra pas mbajtjes së këtij procesverbali, deklarohet nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, pakësim i kursimeve *cash* gjatë vitit 2015, në shumën 1.900.000 lekë.

18.3 Sa më sipër, rezulton se: (i) Ka mospërputhje lidhur me likuiditetet *cash* të deklaruara, pasi bazuar në deklaratat periodike vjetore, gjendja e likuiditeteve *cash* në momentin e dorëzimit të Deklaratës “Vetting” duhet të jetë 1.400.000 lekë<sup>17</sup>, ndërkohë që në Deklaratën “Vetting” nuk deklarohen kursime *cash*; (ii) Ka deklarime kontradiktore në procesverbalet e ILDKPKI-së, të mbajtura brenda një harku të shkurtër kohor, lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, pasi në procesverbalin e datës 29.1.2016 deklarohet se gjendja *cash* prej 4.000.000 lekë është ende në banesë, ndërsa në procesverbalin e datës 23.2.2016, deklarohet se aktualisht gjendja *cash*, në shumën 1.300.000 lekë, është depozituar në bankë.

18.4 Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>18</sup>, në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaramet e vetë subjektit të rivlerësimit, në deklaratat e interesave private, periodike vjetore, konsideruar si provë parësore, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat së bashku me Deklaratën “Vetting” përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit, vlerësojmë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, sa i përket vlerës së *cash*-it jashtë sistemit bankar në vite të ndryshme apo dinamikës së përdorimit të tyre për të mbuluar shpenzime të caktuara, mbetën në nivel deklarativ dhe jo të besueshme.

18.5 Përveç sa më sipër, deklarimet kontradiktore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me likuiditetet *cash*, krijojnë pamundësi në verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive të rrjedhura prej tyre. Më konkretisht, lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, në datë 31.12.2015, rezulton se, nëse gjendja e tyre do të ishte në shumën 4.000.000 lekë, siç deklarohet nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e datës 29.1.2016, që daton edhe para dorëzimit të DV-2015, atëherë kjo do të ndikonte në rezultatin e analizës financiare për vitin 2015.

18.6 Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklaronin brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare. Sipas këtij legjislacioni përcaktohet detyrimi i zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash* dhe jo të nënkuptohet ekzistenca apo ndryshimi i tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte saktësisht dhe plotësisht pasurinë, në rastin konkret likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, duke shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

18.7 Duke përfunduar, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me likuiditetet *cash*, duke pamundësuar verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive të rrjedhura prej tyre.

---

<sup>17</sup> Shuma 1.400.000 lekë përbëhet nga shuma 600.000 lekë kursime *cash*, të deklaruara nga subjekti dhe 800.000 lekë kursime *cash*, të mbetura nga *cash*-i i deklaruar nga personi i lidhur.

<sup>18</sup> Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 27/2020.



**19.** Në lidhje me mjaftueshmërinë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeteve cash në shumën 4.000.000 lekë

19.1 Në DV-2013, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar: Gjendje të ardhurash cash krijuar nga puna në vite, prej vitit 1998, në shumën 4.000.000 lekë.

19.2 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me z. \*\*\*. \*\*\*. në datën \*.5.2013 dhe njohja mes tyre rezulton prej vitit 2010 (udhëtime së bashku dhe përdorim makine). Në pyetësorin standard, i pyetur nga Komisioni lidhur me bashkëjetesën dhe shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshortin z. \*\*\*. \*\*\*. në janar të vitit 2012 dhe shpenzimet janë përballuar bashkërisht.

19.3 Në këto kushte, Komisioni ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara në DV- 2013<sup>19</sup>, përfshirë këtu edhe kursimet cash në shumën 4.000.000 lekë, duke marrë në konsideratë: (i) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e bashkëshortit për periudhën 2001 – 2013, si dhe (ii) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit për periudhën 2012 – 2013<sup>20</sup>. Nga kjo analizë financiare ka rezultuar se për periudhën 2001-2013, duket se ka një mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurive dhe shtesën e kursimeve në vlerën - 3.460.498 lekë. Për pasojë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

19.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka pretenduar se fitimi mesatar i realizuar nga aktiviteti i bashkëshortit është më i lartë nga sa është llogaritur nga Komisioni, si dhe ka paraqitur, në cilësinë e provës, një raport nga audituesi ligjor \*\*\*. \*\*\*.

19.5 Komisioni e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e mësipërm të subjektit të rivlerësimit dhe, pas rilogaritjes së zërave financiarë, i ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën - 1.648.646 lekë<sup>21</sup>.

19.6 Në vijim, Komisioni ka mbajtur në konsideratë gjithashtu faktin se, nga hetimi i kryer, subjekti dhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën cash prej 4.000.000 lekësh për të investuar në të tjera pasuri, gjë e cila do të çonte në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, përveçse për blerjen e automjetit me targa \*\*\*.

19.7 Në përfundim të sa më lart, Komisioni vlerëson se mungesa e të ardhurave financiare, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në

<sup>19</sup> Në DV-2013, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit” subjekti ka deklaruar: llogari rrjedhëse pranë \*\*\* Bank, e krijuar nga të ardhurat nga paga, në shumën 695.724 lekë, ndërsa personi i lidhur me të, ndër të tjera, ka deklaruar: (i) Automjet tip “Audi A4”, me targa \*\*\*, blerë në vlerën 5.700 euro dhe shpenzime doganore, në vlerën 370.000 lekë; (ii) Automjet furgon tip “Mercedes Benz Sprinter”, me targa \*\*\*, blerë në gusht 2013, në vlerën totale 2.100 euro; (iii) Automjet tip “Mercedes Benz”, me targa \*\*\*, blerë në tetor 2013, në vlerën 6.000 euro, dhe shpenzime doganore, në vlerën 210.000 lekë; likuiditete cash, në shumën 4.000.000 lekë.

<sup>20</sup> Periudhë gjatë së cilës subjekti ka deklaruar se ka bashkëjetuar me shtetasin \*\*\*. \*\*\*.

<sup>21</sup> Komisioni ka vlerësuar të aplikojë një marzh fitimi në masën 25,54%, për vitet 2001 – 2006, vite për të cilat nuk ka informacion nga organet kompetente lidhur me fitimin e realizuar dhe një marzh i tillë është i pranueshëm për llojin e aktivitetit që ushtron bashkëshorti (tregti e mallrave industriale). Nga përllogaritjet rezultoi një fitim në shumën 6.058.414 lekë. Ndërkohë që, pavarësisht se në raportin e audituesit ligjor është aplikuar norma e fitimit 25,54 %, edhe në vitet për të cilat ka të dhëna, Komisioni vlerësoi që fitimi për këto vite të mbetet i pandryshuar në shumën totale prej 2.042.120 lekësh, për sa kohë që Bashkia Lushnjë, për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013, ka përcjellë informacion të mjaftueshëm për përcaktimin e fitimit. Ndërsa për vitin 2011, Komisioni vlerësoi të aplikojë një normë fitimi prej 23,82 %, si mesatare e normës së fitimit të vitit paraardhës dhe vitit pasardhës, dhe përllogariti një fitim në shumën 416.815 lekë.

shumën prej -1.648.646 lekësh, për krijimin jo vetëm të pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2013 (përpara martesës ligjore), por edhe të blerjes së pasurive të tjera dhe kryerjes së shpenzimeve përpara vitit 2013, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 13-vjeçare (2001 – 2013), faktet dhe provat rrethore, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të krijojnë bindjen se kjo mungesë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dhe të përbëjë, për pasojë, një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>22</sup>.

**20.** Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, datë 8.9.2021, ndan qëndrim të ndryshëm nga përfundimi i arritur nga Komisioni, duke konstatuar situatën faktike si vijon:

